

VENDIM
Nr.59, datë 30.6.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S
NR.11, DATË 23.6.2006 “PËR DHËNIEN E LICENCE PËR AKTIVITETIN E
PRODHIMIT, SHPËRNDARJES, FURNIZIMIT, IMPORTIT DHE EKSPORTIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE SHOQËRISË KESH SHA”

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pika 1, germa “ç” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 2, paragrafi 9, të modelit të tregut të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008, dhe neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.6.2008, mbasi shqyrtoi propozimin për ndryshimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.11, datë 23.6.2006 “Për dhënien e licencave për aktivitetin e prodhimit, shpërndarjes, furnizimit, importit dhe eksportit të energjisë elektrike shoqërisë KESH sh.a.” dhe konstatoi se:

- Modeli i tregut të energjisë elektrike parashikon si pjesëtar të tregut të energjisë elektrike furnizuesin publik me shumicë, i cili do të funksionojë si një njësi e KESH sh.a. e ndarë funksionalisht dhe financiarisht,

- KESH sh.a. ka aplikuar për përcaktimin e tarifës së furnizuesit publik me shumicë për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2008,

ERE përcakton tarifat e energjisë për aktivitet e licencuara,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.11, datë 23.6.2006 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për dhënien e licencave për aktivitetin e prodhimit, shpërndarjes, furnizimit, importit dhe eksportit të energjisë elektrike shoqërisë KESH sh.a.” në pikën I, shtohet pika 6 me përmbajtjen:

6 – aktivitetin e furnizimit publik me shumicë.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë KESH sh.a., për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta